



# **MONITORIMI I AKSESIT NË INSTITUCIONE PUBLIKE 2014**

Tiranë, 2014



Ky libër u botua në kuadrin e projektit “Përmirësimi i Aksesit në Informacion për Median dhe Qytetarët.” Civil Rights Defenders është partner në këtë projekt.



*Redaktor:* Agim Doksani

*Faqosja:* Bujar Karoshi

© ISHM



Rr. Gjin Bue Shpata, No.8, Tiranë, Albania

*Tel./fax:* ++ 355 4 2229800

*E-mail:* [info@institutemedia.org](mailto:info@institutemedia.org)

[www.institutemedia.org](http://www.institutemedia.org)

# HYRJE

Shqipëria ka patur një ligj për të drejtën e informimit që prej vitit 1999. Edhe pse i konsideruar si një ligj relativisht i mirë në adoptimin e tij, pas 15 vitesh ligji u konsiderua i pamjaftueshëm dhe me mangësi për të garantuar një rregullim të kënaqshëm të së drejtës së qytetarëve për t'u informuar. Për pasojë, pas një sage të rishikimit të ligjit, parlamenti miratoi në shtator 2014 ligjin e ri për të drejtën e informimit.

Miratimi i këtij ligji të ri vjen pas një periudhe të gjatë ku si qytetarët, ashtu dhe mediat, vënë në pikëpyetje transparencën e administratës dhe zbatimit të së drejtës së informimit. Megjithë ndryshimet e bëra ndër vite si dhe progresit teknologjik dhe hapjes së portaleve qeveritare që lehtësojnë dhënien e informacionit, etja për transparencë më të madhe qeveritare mbetet. A është e justifikuar kjo pakënaqësi? Sa njihet dhe sa përdoret në të vërtetë ky ligj i rëndësishëm? Cilat janë problemet kryesore që ndeshen nga të dyja palët? Monitorimet në praktikë të zbatimit të ligjit janë tejet të pakta dhe të rralla për t'u përgjigjur me saktësi.

Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të së drejtës së informimit si për shoqërinë, ashtu dhe për median, ky material synon të hedhë dritë si mbi standardet e rregullimit me ligj të së drejtës së informimit, ashtu dhe mbi zbatimin e këtij ligji në jetën e përditshme. Pjesa e parë e materialit është një krahasim mes standardeve të njohura ndërkombëtare në lidhje me rregullimin e së drejtës së informimit dhe legjislacionit shqiptar në fuqi në këtë fushë. Pjesa e dytë është përshkrimi dhe prirjet kryesore të testimit në praktikë të zbatimit të ligjit nga media dhe qytetarët. Ky testim në praktikë u bë në kohën që ligji i ri sapo kishte hyrë në fuqi, por udhëzimet për zbatimin e tij ishin ende në fazë përgatitore. Për rrjedhojë, nuk mund të gjykohet praktika e testimit me kriteret e ligjit të ri. Gjithsesi, këto përfundime janë të vlefshme dhe duhen mbajtur parasysh edhe për zbatimin e të drejtës së informimit në të ardhmen.



# KRAHASIMI I RREGULLIMIT LIGJOR TË SË DREJTËS PËR INFORMIM NË SHQIPËRI ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE



E drejta e informimit është një e drejtë njerëzore e njohur botërisht. Megjithatë, ashtu si ndodh me çdo të drejtë tjetër, duhet të jetë e balancuar dhe e kufizuar në disa aspekte, me qëllim që të garantohet mbrojtja e të drejtave të tjera dhe të shmangen konfliktet. Në rastin e aksesit në informacion, aktet për lirinë e informimit baraspeshohen ose kufizohen me ligje për informacionin e klasifikuar dhe ligje për mbrojtjen e të dhënave personale.

## **FRYMA E RREGULLIMIT LIGJOR TË SË DREJTËS SË INFORMIMIT**

E drejta themelore për akses në informacionin publik garantohet nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Më konkretisht, neni 19 thotë: “Të gjithë kanë të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur mendime pa ndërhyrje dhe të kërkosh, marrësh dhe japësh informacion dhe mendime nëpërmjet çdo medie, pavarësisht kufijve.” Gjithashtu, Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut mbron dhe garanton plotësisht lirinë e shprehjes si një e drejtë themelore e njeriut dhe njëherësh përpiqet edhe të mbrojë dinjitetin njerëzor kundër shpifjes apo shkeljeve të tjera të ngjashme. Më konkretisht, neni 10 garanton lirinë e shprehjes si një të drejtë të domosdoshme dhe të patjetërsueshme:

*“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë licensimin e ndërmarrjeve të transmetimit audio, kinematografik ose televiziv.”*

Në këtë kontekst, Konventa njeh lirinë për të marrë informacion pa pasur ndërhyrje nga autoritetet publike si një të drejtë themelore të njeriut, të cilën shtetet palë të Konventës duhet ta respektojnë. Gjithashtu, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka marrë vendime të rëndësishme që përbëjnë interpretime të detyrimeve të Konventës dhe si të tilla duhen zbatuar nga gjykatat e të gjitha shteteve palë të Konventës, sa herë të ketë raste të tilla.

Në vitin 1981, Komiteti Ministror i Këshillit të Europës nxori një rekomandim për gjithë shtetet anëtare, i cili i njihte të drejtën të gjithë qytetarëve të këtyre vendeve që të merrnin informacionin nga autoritetet publike, duke bërë një kërkesë për këtë qëllim.

Vendi që ka kaluar i pari një ligj për të drejtën e informimit është Suedia, nga viti 1776. megjithatë, një nga ligjet më të rëndësishme në këtë aspekt ka qenë ai i SHBA i vitit 1966, i cili ka shërbyer si model edhe për vende të tjera që kanë adaptuar më vonë këtë ligj.

Parimi bazë i ligjeve për të drejtën e informimit në botë është se qytetarët kanë të drejtë të kërkojnë materiale që zotërojnë autoritetet publike. Përcaktimi i dokumenteve dhe materialeve që mund të kërkohen ndryshon nga vendi në vend, por mundësia për t'i marrë këto materiale nga autoritetet mbetet i njëjti.

Një tjetër parim bazë është që qytetarët nuk janë të detyruar të motivojnë kërkesën për materialet që duan. Gjithashtu, në disa vende e drejta e informimit i njihet jo vetëm qytetarëve vendas, por kujtdo që kërkon informacion. Madje ka vende të cilat pranojnë edhe që kërkesat të dorëzohen në mënyrë anonime, me qëllim parandalimin e diskriminimit.

Përkufizimi i autoriteteve publike të detyruara të japin informacion për qytetarët ndryshon nga vendi në vend. Ndërkohë që disa vende përfshijnë autoritetet në çdo nivel qeverisjeje, autoritetet gjyqësore,



legjislativë ose të sigurimit që përjashtohen nga detyrimi për të dhënë informacion.

Një pikë e diskutueshme është nëse në autoritetet publike duhen përfshirë edhe kompanitë private që marrin para nga projekte publike. Në disa vende, ligji e ka lejuar kërkesën e informacionit nga këto subjekte, me qëllim që të garantohet respektimi i të drejtave të njeriut.

Natyrisht, e drejta e informimit nuk është e pakufizuar në asnjë vend. Përjashtimet e respektimit të kësaj të drejte zakonisht përfshijnë mbrojtjen e sigurisë kombëtare, jetën private, interesat tregtare, rendin publik, informacionin e marrë në mirëbesim, si dhe diskutimet e brendshme të autoriteteve publike.

Në këtë aspekt, ka shumë ligje që parashikojnë se për t'i mohuar dikujt të drejtën e informimit duhet përdorur testi i interesit publik. Pra, nëse jepet materiali në diskutim dhe kjo gjë shkakton një dëm të caktuar, nëse interesi publik e kërkon që materiali të jepet ose të botohet, atëherë dëmi është më pak i rëndësishëm.

Një tjetër aspekt i ligjeve për të drejtën e informimit ka të bëjë me procedurën e apelit nëse refuzohet një kërkesë për informacion. Këto mund të bëhen brenda vetë strukturës ku kërkohet informacioni si fillim dhe pastaj te një organ i jashtëm, në shumicën e rasteve te Avokati i Popullit ose Komisioneri i të Drejtës së Informimit.

## **PARIMET BAZË TË LEGJISLACIONIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT NË BOTË**

Për t'i bërë edhe më të qarta se cilat janë parimet bazë të dhënies së informacionit për publikun nga autoritetet publike, UNESCO<sup>1</sup> ka hartuar një listë me parimet kryesore që rregullojnë të drejtën e informimit. Këto parime janë hartuar duke u bazuar te një mori dokumentash ndërkombëtare, si nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, rekomandimet përkatëse nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) dhe Këshilli

---

1. T. Mendel, "Freedom of Information: A comparative legal survey," UNESCO, 2008.



## PARIMET BAZË TË LEGJISLACIONIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT NË BOTË

1. Akses maksimal: Aksesit sa më i gjerë ndaj informacionit duhet të jetë parimi udhëheqës i ligjit për të drejtën e informimit.
2. Detyrimi për të bërë informacionin publik: organet publike duhet të jenë të detyruara të bëjnë publik informacione kyç për publikun.
3. Nxitja e qeverisjes së hapur: organet publike duhet të jenë aktive në nxitjen e qeverisjes së hapur.
4. Gamë e kufizuar e përjashtimeve: Përjashtimet duhet të përcaktohen qartë dhe duhet t'i nënshtrohen testeve të rrepta të "interetit publik" dhe të "dëmit."
5. Proceset për të lehtësuar aksesin: Kërkesat për informacion duhet të procedohen me shpejtësi dhe pa diskriminim dhe duhet të ketë një rishikim të pavarur në raste kur refuzohet dhënia e informacionit.
6. Kostot: njerëzit nuk duhet të shkurajohen nga kërkesat për informacion si pasojë e kostove të tepruara.
7. Dhënia e informacionit ka përparësi: Ligjet që bien ndesh me parimin e aksesit maksimal duhet të ndryshohen ose të shfuqizohen.

*T. Mendel, Liria e Informimit, UNESCO, 2008.*

i Europës (KiE), Konventa e Aarhusit, si dhe materiale të tjera të lidhura me to. Sektori i mëposhtëm shpjegon në hollësi secilin nga këto parime.<sup>2</sup>

### **1. Akses maksimal: Aksesit sa më i gjerë në informacion duhet të jetë parimi udhëheqës i ligjit për të drejtën e informimit.**

Ky parim nënkupton që gama e të drejtës për informim të jetë mundësisht sa më e gjerë, përsa i përket llojit të informacionit të kërkuar,

2. Lista e hartuar nga UNESCO përmbante dhe dy parime shtesë: mbledhjet e qeverisë duhet të jenë të hapura për publikun dhe mbrojtjen për bilbilfryrësit. Meqenëse ky botim trajton vetëm dhënien e informacionit, këto dy parime nuk janë analizuar si pjesë e botimit.



organeve nga të cilat mund të kërkosh informacion, si dhe personave që mund ta ushtrojnë të drejtën e informacionit. Duke pasur parasysh që shumë persona mund të mos jenë në gjendje të identifikojnë me saktësi dokumentin që kërkojnë, ky akses nënkupton që atyre t'u jepet ndihma e duhur edhe për të identifikuar dokumentin apo informacionin e kërkuar.

## **2. Detyrimi për të bërë informacionin publik: organet publike duhet të jenë të detyruara të bëjnë publik informacione kyç për publikun.**

Për ta zbatuar në praktikë të drejtën e informimit nuk mjafton thjesht t'u drejtosh organeve publike kërkesa për informacion. Aksesit i vërtetë përfshin edhe detyrimin e këtyre organeve për të bërë publik informacion thelbësor, pa qenë nevoja që dikush ta kërkojë këtë gjë. Natyrisht që gama e publikimit të informacionit ndryshon në varësi të organit publik dhe mundësive që ka për publikim, por parimi është që me kalimin e kohës sasia e informacionit të bërë publik duhet të vijë në rritje, sidomos me lehtësinë e teknologjive të reja.

## **3. Nxitja e qeverisjes së hapur: organet publike duhet të jenë aktive në nxitjen e qeverisjes së hapur.**

Në shumë vende ekziston një kulturë e rrënjësor e sekretit shtetëror dhe në fund të fundit e drejta e informimit varet nga ndryshimi i këtij mentaliteti, pasi vështirë se edhe ligji më përparimtar mund ta detyrojë nëpunësin më të mbyllur të japë informacion. Pas miratimit të një ligji të mirë hapi i parë që duhet bërë është puna bindëse se një qeveri e hapur që i jep informacion publikut është një e drejtë themelore. Për këtë arsye mund të nevojiten një sërë masash për të ndryshuar kulturën e shtetit të mbyllur dhe për të garantuar të drejtën e informimit për publikun. Masat në këtë aspekt mund të jenë të ndryshme, të tilla si: caktimi i një organi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të së drejtës për informim, edukimi i publikut, botimi i udhërrëfyesve për të drejtën e informimit, etj. Masa të rëndësishme janë edhe sanksionet në rastet kur nuk respektohet e drejta e informimit, përfitimet për zbatuesit e zellshëm të së drejtës së informimit, si dhe mjete monitorimi të vazhdueshëm për gjendjen e zbatimit të së drejtës së informimit.





#### **4. Gama e kufizuar e përjashtimeve: Përjashtimet duhet të përcaktohen qartë dhe duhet t'i nënshtrohen testeve të rrepta të “interesit publik” dhe të “dëmit.”**

Vendosja e përjashtimeve për zbatimin e të drejtës së informimit është një detyrë delikate. Kufizimet e tepruara mund të përdoren nga qeveria për të mohuar dhënien e informacionit dhe mund të sabotojnë një ligj të mirë për të drejtën e informimit. Nga ana tjetër, është gjithashtu e rëndësishme dhe e domosdoshme të ruhen informacione që duhet të jenë sekrete. Këto kufizime të informimit duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare për kufizimin e lirisë së shprehjes, domethënë të jenë të nevojshme në një shoqëri demokratike dhe të jenë proporcionale me mbrojtjen që duhet të ofrojnë ndaj informacionit të ndjeshëm. Rekomandimi i Këshillit të Europës citon një listë të hollësishme të arsyeve për të kufizuar të drejtën e informimit:

- siguria kombëtare, mbrojtja, si dhe marrëdhëniet ndërkombëtare;
- siguria publike;
- parandalimi, hetimi dhe procedurimi ndaj aktivitetit kriminal;
- mbrojtja e jetës private;
- mbrojtja e interesave ekonomike, publike dhe private;
- garancia e barazisë për palët që janë në gjyq;
- mbrojtja e mjedisit;
- inspektimi, kontrolli dhe mbikëqyrja nga autoritetet publike;
- politikat shtetërore ekonomike, monetare dhe të shkëmbimit të monedhës;
- garantimin e konfidencialitetit për diskutimin mes autoriteteve publike gjatë përgatitjes së brendshme të një çështjeje të caktuar.

Natyrisht që dhënia e informacionit nuk mund të refuzohet thjesht sepse informacioni i kërkuar është në një nga këto kategori. Për të përcaktuar rastet kur mund të refuzohet informacioni na vjen në ndihmë testi i trefishtë i krijuar nga Article 19:

- informacioni duhet të ketë një qëllim të përligjur, të shprehur në ligj;
- publikimi i informacionit duhet të kërcënojë ose të dëmtojë seriozisht këtë qëllim;
- dëmtimi i qëllimit duhet të jetë më i madh sesa interesi publik për ta publikuar këtë informacion.



## **5. Proceset për të lehtësuar aksesin: Kërkesat për informacion duhet të procedohen me shpejtësi dhe pa diskriminim dhe duhet të ketë një rishikim të pavarur në raste kur refuzohet dhënia e informacionit.**

Garantimi i zbatimit të së drejtës së informimit në praktikë kërkon jo vetëm publikimin vullnetar të informacionit nga organet publike, por edhe që kushdo duhet të ketë të drejtën të kërkojë dhe të marrë informacionin që kanë organet publike, me disa përjashtime. Ky parim kërkon që të caktohen procedura të qarta për mënyrën se si organet publike duhet të përpunojnë kërkesat për informacion. Është gjithashtu e nevojshme që të ketë një sistem monitorimi nga një organ i pavarur për vendimet për të dhënë informacion.

Dokumentet ndërkombëtare për të drejtën e informimit vendosin kriteret e ndryshme për procedurat e zbatimit të së drejtës së informimit, me qëllim që të ketë një sistem të hapur, lehtësisht të aksesueshëm për të garantuar të drejtën e informimit. Rekomandimi i Këshillit të Europës është nga më të hollësishmit, duke vendosur këto kriteret:

- kërkesat për informacion duhen pranuar nga të gjitha organet publike që mbartin informacion, në mënyrë të barabartë dhe me minimumin e formalitetit;
- kërkesat e informacionit nuk duhet të jenë të detyruar të japin arsye për kërkesat e tyre;
- kërkesat duhen proceduar shpejt dhe brenda afateve të caktuara kohore;
- kërkesat e informacionit duhen ndihmuar “sa më shumë të jetë e mundur”;
- duhet arsyetuar çdo refuzim për të dhënë informacion;
- kërkesat duhet të marrin informacionin në formën që duan, ose duke marrë një kopje ose duke parë dokumentin origjinal.

Një tjetër kriter i rrënjosur në praktikën e rregullimit të së drejtës për informim është që kushdo duhet të ketë të drejtën për ankimim në rastet kur nuk merr dot informacion. Mundësisht, ky ankimim duhet të gjykohet nga një organ i pavarur, si komisioneri për informimin apo organe të ngjashme. Në këtë proces kriteri tjetër që duhet respektuar është që barra e provës për arsyet se përse informacioni i kërkuar duhet të jetë i kufizuar duhet të bjerë mbi autoritetin publik.

## **6. Kostot: njerëzit nuk duhet të shkurajohen nga kërkesat për informacion si pasojë e kostove të tepruara.**

Caktimi i kostove të arsyeshme për dhënien e informacionit është një çështje e rëndësishme. Nga njëra anë, nëse kostot janë të larta, ato bëhen pengesë për zbatimin e ligjit. Nga ana tjetër, nëse procesi i dhënies së informacionit ka realisht kosto të larta, duhet garantuar financimi i nevojshëm për të zbatuar të drejtën e informimit. Parimi i përgjithshëm i zbatuar në këtë pikë është se në përgjithësi marrja e informacionit duhet të jetë falas. Edhe në rastet kur është me pagesë, pagesa nuk duhet të jetë më shumë sesa kostot e kopjimit të informacionit.

## **7. Dhënia e informacionit ka përparësi: Ligjet që bien në kundërshtim me parimin e aksesit maksimal duhet të ndryshohen ose të shfuqizohen.**

Është e qartë që në çdo vend do të ketë një përplasje mes ligjeve për sekretin shtetëror dhe ligjeve për të drejtën e informimit. Secili shtet duhet të ketë një mekanizëm ligjor për të trajtuar rastet kur ekziston ky konflikt. Ndërkohë që sugjerohet një rishikim i herëpashershëm i ligjeve për sekretin shtetëror, rekomandohet gjithashtu që ligji për të drejtën e informimit të ketë përparësi mbi ligjet e tjera. Parimi që zbatohet në këtë rast është se klasifikimi i një dokumenti si sekret shtetëror nuk duhet përdorur si justifikim për të mohuar dhënien e informacionit, por klasifikimi duhet parë me sy kritik nëse është i nevojshëm apo është tashmë i tejkalluar.



## **LEGJISLACIONI SHQIPTAR PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Legjislacioni shqiptar garanton të drejtën për informim. Kjo e drejtë njihet që në nenin 23 të Kushtetutës:

1. E drejta e informimit është e garantuar.
2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.

3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

Kjo e drejtë është trajtuar më gjerë në Ligjin për Akses në Dokumentat Zyrtare, Ligji nr.8503, i datës 30.06.1999. Ligji u konsiderua në përgjithësi i mirë, por me kalimin e kohës u vunë re mangësi në përkufizimin shterrues të disa nocioneve, afatet e zgjatura në mënyrë të tepruar, pamjaftueshmëri të sanksioneve, roli i pamjaftueshëm mbikëqyrës i Avokatit të Popullit, etj.

Për pasojë, që nga viti 2007 ka patur përpjekje nga shoqëria civile, me nismën e Justice Initiative, për ta ndryshuar këtë ligj. Kjo nismë kaloi në një proces të gjatë diskutimi me administratën dhe me organizata të shoqërisë civile, duke shqyrtuar propozimet e bëra për të ndryshuar ligjin ekzistues. Megjithë vullnetin e mirë të shprehur në takime publike nga ana e qeverive të kaluara dhe të tanishme për ndryshimin e ligjit, u deshën më shumë se shtatë vjet që ligji i ri të miratohej në parlament në shtator të vitit 2014. Ligji i ri, falë ekspertizës ndërkombëtare, përfshirjes së shoqërisë civile, si dhe procesit të gjatë të diskutimit u përshëndet si një ligj mjaft i mirë, i cili “parashikon një sërë rregullash favorizuese, që në ndryshim nga ligji i mëparshëm, i japin mundësinë e kthimit të tij në një ligj praktik e të vlefshëm.”<sup>3</sup> Duke pasur parasysh parimet bazë që duhet të udhëheqin një ligj të mirë të së drejtës së informimit, të shtjelluara më sipër, më poshtë është një analizë e ligjit të ri shqiptar për të drejtën e informimit, duke ndjekur këto parime.

12

**I. Akses maksimal: Aksesit sa më i gjerë në informacion duhet të jetë parimi udhëheqës i ligjit për të drejtën e informimit.**

Ligji i ri ka patur për qëllim të japë një përkufizim sa më të gjerë të asaj që përbën informacion që publiku duhet ta ketë. Sipas përcaktimit të nenit 3 të ligjit “Për të Drejtën e Informimit”: “Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet. Autoriteti Publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse e ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik nëpërmjet dokumentacionit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të

---

3. Respublica, “Komentari i ligjit nr.119/2014 Për të drejtën e informimit,” 2014.

plotë në përmbajtjen e dokumentit. Informacioni publik që i është dhënë një personi nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit në përputhje me nenin 17 të këtij ligji”.

Gjithashtu, ligji përpiqet të përcaktojë qartë se cilat janë autoritetet publike që duhet të japin informacion. Ky term përfshin:

- Institucionet e administratës shtetërore, qendrore apo lokale, të cilat funksionojnë në bazë të ligjit për procedurën administrative.
- Organet ligjvënëse.
- Institucionet në varësi direkte apo indirekte të tyre.
- Entet Publike të krijuara me ligje të veçanta apo nga detyrimi kushtetues.
- Kompanitë private ku shteti ka aksione pavarësisht nga përqindja e pjesëmarrjes së tij për atë pjesë të aktivitetit që lidhet me ushtrimin e funksionit të tij publik.
- Gjykatat dhe Prokuroritë e çdo niveli për atë pjesë të aktivitetit që lidhet me funksionin publik të tyre.
- Personi fizik apo juridik, të cilit në bazë të ligjit i është dhënë e drejta e ushtrimit të funksionit publik.

Në po të njëjtën vazhdë arsyetimi, ligji përcakton edhe atë që është informacion publik, si më poshtë:

- Të gjitha llojet e dokumentacioneve që hyjnë dhe dalin nga autoriteti publik të protokolluara në formë të shkruar.
- Të gjitha llojet e dokumenteve që harton vetë institucioni për të realizuar objektivat e tij të punës si psh. relacionet, studimet, vlerësimet, udhëzimet, rregulloret, dosjet e ndryshme si dosjet e prokurimeve, të prokurorisë, të gjykatës etj, që konsiderohen si dokumentacion i krijuar nga vetë autoriteti publik.

Po kështu, ligji i njuh të drejtën e kërkimit të informacionit, si shtetasve shqiptarë, ashtu edhe atyre të huaj. Pra, ligji “Për të Drejtën e Informimit” i njuh çdo personi fizik apo juridik të drejtën për t’u njohur me informacionin që prodhohet dhe mbahet nga autoriteti publik nëpërmjet një kërkese drejtuar autoritetit publik përkatës. Gjithashtu, parimi i njohjes maksimale me informacionin publik është vendosur si detyrim edhe për tërë autoritetet publike, në krijimin e programit të transparencës (shih më poshtë.)



## **2. Detyrimi për të bërë publik informacionin: organet publike duhet të jenë të detyruara të bëjnë publik informacione kyç për publikun.**

Një risi e rëndësishme e ligjit të ri për të drejtën e informimit ka të bëjë me konceptimin e një qasjeje proaktive për transparencë si një detyrim të qeverisë ndaj qytetarëve. Për këtë qëllim, ligji ka përcaktuar marrjen e masave konkrete si dhe ngritjen e strukturave të posaçme. Pjesë e këtyre masave është edhe detyrimi që autoritetet publike të vënë në dispozicion të publikut, pa asnjë lloj kërkesë paraprake, në të gjitha format e mundshme, dokumentacionin apo ta informatizojnë atë në faqen e internetit në mënyrë që të lehtësojnë informimin e publikut.

Kështu, ligji përcakton qartë kategoritë e informacionit që duhen publikuar nga vetë autoritetet, pa kërkesë informacioni nga publiku:

- Vendndodhjen e autoritetit publik dhe listën me numrat e telefonit për çdo sektor dhe drejtori.
- Strukturën organizative, funksionet dhe detyrat e autoritetit publik.
- Tekstet e plota të kuadrit ligjor mbi të cilin ushtron aktivitetin e tij autoriteti publik të tilla si ligjet, vendimet, udhëzimet, konventat e ratifikuara, marrëveshjet e nënshkruara, rregulloret e brendshme, kodin e etikës etj.
- Procedurat e shkruara në lidhje me procesin e pranimit dhe shqyrtimit të kërkesës për informim.
- Të dhënat për arsimin, pagat dhe detyrimin e funksionarëve të lartë për deklarimin e pasurive, strukturën e pagave për të gjitha nivelet e punonjësve.
- Raportet e auditit të brendshëm, të Kontrollit të Lartë të Shtetit.
- Buxhetin, planet e shpenzimeve, shpenzimet e kryera, realizimin e buxhetit, mbledhjen e të ardhurave nga burime të treta etj.
- Informacione sipas Ligjit të Prokurimeve Publike dhe të Koncesionit siç janë lista e kontratave të lidhura, shumat e kontraktuara, palët kontraktuese, përshkrimi i shërbimit që kryhet, etj.
- Përshkrim të shërbimeve që autoriteti publik i ofron publikut dhe cilësinë e shërbimit.
- Procedurat e ankimit në rast të mosrespektimit apo moskryerjes së funksioneve publike nga ana e autoritetit publik.

- Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve për informim.
- Informacione dhe dokumente që është konstatuar se zgjojnë interes për publikun dhe kërkojnë shpesh.
- Çdo informacion tjetër që autoriteti publik gjykon se është në interes të publikut.
- Një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato.
- Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si edhe të kategorive të informacionit që bëhen publike pa kërkesë.
- Çdo mekanizëm apo procedurë përmes së cilës persona të interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo lloj mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike, apo të ushtrimit të funksionit të autoritetit publik.

Të gjitha këto informacione duhet t'i vihen në dispozicion në mënyrë të menjëhershme dhe falas publikut.

### **3. Nxitja e qeverisjes së hapur: organet publike duhet të jenë aktive në nxitjen e qeverisjes së hapur.**

Me po të njëjtin arsyetim dhe në kuadrin e nismës për një qeveri të hapur, ligji i ri i kushton vëmendje të veçantë krijimit të kushteve të nevojshme për një transparencë sa më maksimale të qeverisë ndaj qytetarëve. Një detyrë themelore e Autoritetit Publik, sipas përcaktimit të ligjit “Për të Drejtën e Informimit” është edhe hartimi dhe miratimi i Programit Institucional të Transparencës. Ky program do të përmbajë të gjithë dokumentacionin, që do të bëhet publik pa kërkesën e individit dhe do të përcaktojë edhe mënyrën e bërjes publike. Forma standarde e publikimit është nëpërmjet faqes së internetit të autoritetit publik duke rritur kështu mundësinë e gjetjes të sa më shumë informacioneve në këtë faqe, duke dixhitalizuar të gjitha dokumentet zyrtare, aktet ligjore, nënligjore, marrëveshjet etj. sipas përcaktimit të ligjit “Për të Drejtën e Informimit”.

Ky program institucional duhet të ketë parasysh dy aspekte:

- I. Garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik



2. Vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informim

Ky program duhet të hartohet në përputhje me modelin që ka miratuar Komisioneri i të Drejtës për Informim. Rishikimi i programit të transparencës do të bëhet sipas së njëjtës procedurë që është bërë edhe miratimi i tij, por afati i rishikimit do të ndryshojë sipas specifikës së autoritetit publik në vartësi të informacionit që prodhon çdo autoritet.

#### **4. Gamë e kufizuar e përjashtimeve: Përjashtimet duhet të përcaktohen qartë dhe duhet t'i nënshtrohen testeve të rrepta të “interesit publik” dhe të “dëmit.”**

Ligji “Për të Drejtën e Informimit”, në nenin 17 të tij përcakton katër kategori kur mund të kufizohet e drejta për informim. Megjithatë, duhet vënë në dukje se për çdo kategori ligji përcakton qartë se e drejta e informimit mund të kufizohet vetëm “në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat” e secilës kategori. Më konkretisht në kategorinë e parë përfshihen:

- e drejta për një jetë private;
- sekreti tregtar;
- e drejta e autorit;
- patentat.

Përjashtohen këto kufizime atëherë kur:

- a. Titullari i mbajtjes së këtyre të drejtave, jep pëlqimin vetë për dhënien e informacionit.
- b. Kur titullari i mbajtjes së këtyre të drejtave në momentin e dhënies së këtyre informacioneve është quajtur autoritet publik.
- c. Në rastet kur dhënia e informacionit ka interes publik më të lartë sesa kufizimi i saj.

Kategoria e dytë e kufizimeve përfshin:

- sigurinë kombëtare;



- parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale;
- mbarëvajtjen e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor (kufizimi nuk zbatohet nëse hetimi ka përfunduar);
- mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike (kufizimi nuk zbatohet nëse hetimi ka përfunduar);
- formulimin e politikave monetare dhe fiskale të shtetit (kufizimi nuk zbatohet nëse të dhënat janë fakte, analiza të fakteve, të dhëna teknike ose të dhëna statistikore);
- barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor (kufizimi nuk zbatohet nëse të dhënat janë fakte, analiza të fakteve, të dhëna teknike ose të dhëna statistikore);
- këshillimin dhe diskutimin paraprak brenda ose midis autoriteteve publike për zhvillimin e politikave publike (kufizimi nuk zbatohet pasi politikat janë bërë publike);
- mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare ose ndërqeveritare.

Përveçse informacioni në këtë kategori duhet të kufizohet vetëm nëse është e domosdoshme dhe kufizimi duhet të jetë proporcional, ligji për këtë kategori ka shtuar edhe kriterin e interesit publik: “Informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij.”

Kategoria e tretë e rasteve kur mund të kufizohet informacioni, gjithnjë në mënyrë proporcionale dhe vetëm nëse është e domosdoshme, është në rastin kur cenohet sekreti profesional i garantuar nga ligji.

Kategoria e katërt e mundësisë për kufizim informacioni ka të bëjë me rastet kur, “pavarësisht nga ndihma e dhënë nga autoriteti publik, kërkesa mbetet e paqartë dhe bëhet i pamundur identifikimi i informacionit të kërkuar.” Pra, ky kufizim ka të bëjë me formulimin e kërkesës sesa me llojin e informacionit që do të jepet.

Ligji parashikon edhe rastin e kufizimit në rastet kur informacioni është sekret shtetëror (shih më poshtë Parimin 7.)



**5. Proceset për të lehtësuar aksesin: Kërkesat për informacion duhet të procedohen me shpejtësi dhe pa diskriminim dhe duhet të ketë një rishikim të pavarur në raste kur refuzohet dhënia e informacionit.**

Ky parim është një nga aspektet ku ligji ka pësuar ndoshta ndryshimin më rrënjësor në krahasim me ligjin e mëparshëm. Ndryshimi lidhet kryesisht me krijimin e strukturave të reja përgjegjëse për të lehtësuar dhënien e informacionit, krijimin e një autoriteti mbikëqyrës me kompetenca më të gjera se më parë, si dhe në shkurtimin e ndjeshëm të afateve.

***Koordinatori për të Drejtën e Informimit***

Koordinatori i të Drejtës për Informim është personi i ngarkuar me këtë detyrë nga autoriteti publik, pjesë e stafit të tij, i cili merret në mënyrë ekskluzive me të drejtën e informimit. Detyrat e koordinatorit janë si më poshtë:

- i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas këtij ligji, duke u konsultuar me dokumentin origjinal ose duke marrë një kopje të tij;
- krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve;
- bashkërendon punën për plotësimin e kërkesave për informacione brenda afateve dhe sipas mënyrës së parashikuar në këtë ligj;
- regjistron kërkesat për informacion dhe cakton një numër rendor për secilën prej tyre;
- dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar;
- verifikon rastet për dhënien falas të informacionit qytetarëve;
- kryen njoftimet paraprake për mënyrën e njohjes me informacionin apo në raste shtyrje afati, si dhe komunikon me kërkuar sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Autoriteti Publik pas caktimit të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit duhet të hartojë dhe të miratojë një rregullore për funksionimin e kësaj strukture. Në këtë rregullore duhet të jenë përcaktuar qartë:

1. Procedura e pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave për informim, duke filluar nga orari i pranimit të kërkesave, asistenca në raste të nevojshme, që duhet t'u jepet kërkuësve për hartimin e kërkesës, mënyra e komunikimit me kërkuësin, etj.
2. Procedura e kthimit të përgjigjeve, refuzimeve apo të shtyrjes së afateve duke dhënë modelet e tyre.
3. Tarifat e nevojshme për shërbimin e informimit. Në këtë rast mund të ketë tarifa fikse për disa lloj shërbimesh, ndërsa për shërbime të tjera më të ndërlikuara vendosja e tarifës mund të lihet në kompetencë të sektorit përkatës dhe zyrës së financës gjithmonë në përputhje me kufizimet që përcakton ligji për këtë qëllim.

### ***Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve***

Një tjetër risi e ligjit është detyrimi që autoritetet publike të krijojnë, mbajnë dhe të bëjnë publik një regjistër me të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje. Regjistri duhet përditësuar çdo tre muaj dhe të botohet në faqen online të autoritetit publik, duke ruajtur anonim identitetin e kërkuësve të informacionit. Kjo është një risi e rëndësishme pasi është një mjet që do ta bënte autoritetin publik më të ndjeshëm ndaj detyrimit për të dhënë informacion, por edhe do t'ua lehtësonte punën kërkuësve të informacionit dhe autoritetit, duke krijuar një skedë të gatshme të informacionit të dhënë. Po kështu, kjo është një rrugë e mirë për të parë masën e zbatimit të së drejtës për informim në praktikë.

### ***Mënyra e dërgimit të kërkesës dhe të dhënies së informacionit***

Kërkesa për informacion mund të dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike dhe duhet të përmbajë identitetin e kërkuësit dhe informacionin për ta kontaktuar, përveç përshkrimit të informacionit që kërkohet.



Përsa i përket marrjes së informacionit, ligji përcakton se të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet. Në rastet kur kërkesat lidhen me dokumente të shkruara, në dispozicion të kërkuarit vihet një kopje e plotë në formatin që disponon autoriteti publik, ose një kopje e plotë e informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet. Në çdo rast, vendimi i refuzimit për formën e kërkuar jepet me shkrim dhe i arsyetuar.

### **Afatet kohore**

Përsa u përket afateve kohore, sipas ligjit, autoriteti publik është i detyruar që brenda 10 ditëve pune nga dita e regjistrimit të kërkesës në regjistër, të kthejë përgjigje për informacionin e kërkuar. Në rastet kur autoriteti publik konstaton se informacioni i kërkuar nuk disponohet nga ai, atëherë ia përcjell kërkesën autoritetit publik përkatës dhe autoriteti i dytë që ka informacionin duhet t'i kthejë përgjigje kërkuarit brenda 15 ditëve pune pas dorëzimit të kërkesës. Kur kërkesa është e paqartë për autoritetin publik, brenda 48 orëve duhet të njoftojë kërkuarin për të bërë sqarimet e nevojshme dhe të domosdoshme. Atëherë kur informacioni i kërkuar është kompleks dhe voluminoz, autoriteti publik është i detyruar të njoftojë me shkrim apo me gojë kërkuarin se ka nevojë për një shtyrje të afatit, por jo më shumë se 5 ditë pune. Kjo shtyrje mund të bëhet vetëm një herë. Një mundësi tjetër është që autoriteti i kërkon kërkuarit të modifikojë kërkesën e tij në përshtatje me mundësinë që autoriteti publik ka për t'i kthyer përgjigje dhe kërkuari zgjedh një nga këto dy mundësi.

### **Komisioneri për të Drejtën e Informimit**

Komisioneri për të Drejtën e Informimit është pjesë përbërëse e strukturës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si institucion i krijuar me ligj të veçantë.

Në kuadër të zbatimit të ligjit “Për të Drejtën e Informimit” ai ka këto kompetenca:



1. Miraton modelin e programit të transparencës për çdo autoritet publik, pasi llojet e informacioneve, dokumentacioni, forma e mbajtjes dhe ruajtja e tyre, klasifikimi i dokumenteve është specifik për çdo autoritet publik.
2. Përcakton standardin për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit të kërkesave si dhe të përgjigjeve për informacion.
3. Shqyrton në mënyrë periodike së bashku me Ministrinë e Financave tarifat e shërbimit që autoriteti publik ka bërë publike dhe në rastet kur konstaton apo kur në gjykimin e tij tarifat janë të larta, atëherë ndërhyr për ndryshimin e tyre. Ndërhyrja e tij është e detyrueshme për t'u zbatuar nga autoriteti publik.
4. Vendos gjoba për personat përgjegjës pranë autoritetit publik për shkelje dhe moszbatim korrekt të ligjit “Për të Drejtën e Informimit”. Me kalimin e afatit 6-mujor, vendimi i Komisionerit kthehet në urdhër ekzekutiv dhe zbatohet nga zyra e financës së autoritetit publik.
5. Pranon ankimet nga kërkuesit në lidhje me kërkesat për informacion dhe i shqyrton ato sipas një procedure që ia njej ligji “Për të Drejtën e Informimit”. Vendimet e tij janë detyruese për autoritetin publik. Gjithashtu vendimet e tij janë të ankimueshme si nga ana e kërkuesit, ashtu edhe nga ana e autoritetit publik. Ankimi i vendimeve të Komisionerit bëhet pranë Gjykatës Administrative të shkallës së parë.
6. Komisioneri raporton përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për ecurinë dhe zbatimin e ligjit “ Për të Drejtën e Informimit ”.

### **Shkeljet dhe sanksionet administrative**

Mosrespektimi i neneve të ligjit “Për të Drejtën e Informimit” sigurisht që çon në përcaktimin e përgjegjësiave administrative sipas përcaktimeve që janë bërë në këtë ligj.

Çfarë do të konsiderohet kundërvajtje administrative? Sipas ligjit, kundërvajtja administrative është veprimi apo mosveprimi në përputhje me këtë ligj për aq sa nuk përbën vepër penale, dhe dënohet me gjobë. Ligji përcakton një sërë veprimesh apo mosveprimesh që mund të përbëjnë



kundërvajtje administrative dhe parashikon për secilën masën e gjobës. Kundërvajtjet janë:

- Refuzimi i dhënies së informacionit në kundërshtim me ligjin.
- Mosvënja në zbatim në afatin e caktuar, sipas ligjit, të programit institucional të transparencës.
- Mosrishikimi i programit institucional të transparencës brenda afatit ligjor.
- Mosndjekja e procedurave të rishikimit të programit institucional të transparencës.
- Moskrijimi, mosmbajtja, mospublikimi dhe mopërditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve brenda afateve ligjore.
- Mosplotësimi i kërkesave për informacion të regjistruara në regjistër, brenda afateve kohore ligjore.
- Mosregjistrimi i kërkesës për informim, moscaktimi i një numri rendor për të dhe mosdhënia e të dhënave të kontaktit të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit sipas ligjit.
- Mosdërgimi i kërkesës për informim te një autoritet tjetër publik brenda afateve kohore që përcakton ligji.
- Dërgimi i kërkesës për informim te një autoritet tjetër kur vetë autoriteti e ka këtë informacion.
- Mosnjoftimi i kërkuesit se kërkesa e tij është dërguar në një tjetër autoritet publik, i cili e zotëron informacionin.
- Mospërcaktimi paraprak i tarifës, mos publikimi i tarifave apo caktimi i një tarife abuzive në kundërshtim me ligjin.
- Mosrespektimi i kërkesave ligjore për dhënie falas të informacionit.
- Refuzimi i paarsyetuar i preferencës që kërkuesi ka për të marrë.
- Mosnjoftimi i kërkuesit për zgjatjen e afatit të plotësimit të kërkesës.
- Moskryerja e njoftimeve paraprake sipas përcaktimeve në ligj.
- Dëmtimi apo shkatërrimi i dokumenteve zyrtare për të shmangur të drejtën e informimit.
- Moszbardhja e dokumenteve zyrtare sipas ligjeve në fuqi për të shmangur të drejtën për informim.

Ligji parashikon dhe masën e gjobës që mund të vendoset për këto shkelje, ku më e ulta është 25.000 lekë, ndërsa më e larta është 300.000 lekë. Përgjegjësia për shkeljet e konstatuara ndahet në varësi të shkeljes midis titullarit të autoritetit publik, Koordinatorit për të Drejtën e Informimit

dhe në disa raste dhe për nëpunës të autoritetit publik. Gjoha që u është vendosur personave përgjegjës, titullarit të autoritetit publik, koordinators dhe nëpunësit shlyhet prej tyre me këste mujore duke pasur parasysh që familjeve të tyre të mos iu cenohet minimumi jetik. Sanksioni administrativ është i ankimeshëm në përputhje me procedurat e ligjit “Për Kundërvajtjen Administrative”. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së autoritetit publik ku punon kundërvajtësi brenda 6 muajve nga çasti që kjo gjobë është vendosur. Me kalimin e afatit 6-mujor vendimi kalon në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyra e përmbartimit me kërkesë të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

## **6. Kostot: njerëzit nuk duhet të shkurajohen nga kërkesat për informacion si pasojë e kostove të tepruara.**

Autoriteti publik përcakton tarifa për ofrimin e shërbimit të dhënies së informacionit të kërkuar. Kjo tarifë nuk duhet të përdoret nga autoriteti publik për të trembur kërkuar dhe për të kufizuar kërkesat për informim. Tarifa vendoset rast pas rasti, por duhet t’i bëhet e ditur kërkuar në çastin e pranimit të kërkesës.

Tarifat për shërbimet standarde ose ato për të cilat është krijuar një përvojë duhet të jenë të miratuara nga rregullorja e brendshme e funksionimit të autoritetit publik apo të miratuara me një urdhër të brendshëm të institucionit dhe duhet të bëhen publike.

Tarifa që mund t’i ngarkohet kërkuar të informacionit si kundërshtëpblim i kostos materiale llogaritet duke përfshirë këto shpenzime:

1. Shpenzimet e riprodhimit të kostos së dokumentit zyrtar, fotokopje, printime apo kopjime në format kompjuterik ose forma të tjera.
2. Shpenzime për dërgim informacioni ku hyjnë posta, faksi, telefoni, interneti etj.

Duhet të kemi parasysh se në pagesën për shërbimin e informacionit nuk mund të përfshihen shpenzimet për përgatitjen e materialit nga nëpunësi që do të thotë shtypja në kompjuter, kostoja e kërkimit të dokumentit, kostoja e shqyrtimit të kërkesës dhe kosto të tjera si këto.



Kërkuesi nuk do të paguajë tarifë shërbimi për informacionet që autoriteti publik është ligjërish i detyruar t'i publikojë ato duke i vënë në dispozicion të publikut pa kërkesë.

## **7. Dhënia e informacionit ka përparësi: Ligjet që bien në kundërshtim me parimin e njohjes maksimale me informacionin publik duhet të ndryshohen ose të shfuqizohen.**

Natyrisht që dhënia e informacionit nuk mund të jetë e pakufizuar edhe brenda ligjit për të drejtën e informimit parashikohen kufizime të kësaj së drejte. Për më tepër, dy ligje të tjera kyesore kufizojnë të drejtën për informim, Ligji i Informacionit të Klasifikuar si Sekret Shtetëror dhe Ligji për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale.

Sipas Ligjit të Informacionit të Klasifikuar si Sekret Shtetëror sekreti shtetëror përcaktohet si çdo informacion i klasifikuar që, nëse do të nxirret në një mënyrë të paautorizuar, do të rrezikonte sigurinë kombëtare. Informacion që mund të klasifikohet përfshin informacionet për:

- plane, armë, operacione ushtarake;
- sistemet, instalimet, projektet dhe planet e lidhura me sigurinë kombëtare;
- veprimet, format, metodat e shërbimit të inteligjencës dhe të sistemit të shifrimit;
- informacioni i qeverive të huaja, marrëdhëniet ndërkombëtare, burimet konfidenciale;
- çështjet shkencore, ekonomike, teknologjike të lidhura me sigurinë kombëtare;
- kategori të tjera informacioni të klasifikuara si sekrete shtetërore nga personat e autorizuar.

Në varësi të llojit të informacionit, ligji i ndryshuar ravijëzon katër nivele rëndësie të informacionit të klasifikuar:

- i kufizuar: dhënia e paautorizuar mund të dëmtojë veprimtarinë ose efikasitetin e organeve shtetërore në fushën e sigurisë kombëtare;



- konfidenciale: dhënia e paautorizuar mund të dëmtojë sigurinë kombëtare;
- sekrete: dhënia e paautorizuar mund të rrezikojë shumë sigurinë kombëtare;
- shumë sekrete: dhënia e paautorizuar mund të rrezikojë jashtëzakonisht shumë sigurinë kombëtare.

Mbrojtja e të dhënave personale në legjislacionin shqiptar rregullohet me Ligjin nr. 8517, “Për mbrojtjen e të dhënave personale,” të miratuar në vitin 1999. Ligji në fuqi pohon se subjekti i të dhënave duhet të njoftohet dhe të japë pëlqimin për përpunimin dhe gjithashtu i njëj këtij subjekti të drejtën për të parë të dhënat e veta personale, së bashku me të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e këtyre të dhënave. Në rastet kur mendohet se ka pasur parregullsi në përpunimin e të dhënave, subjekti mund të bëjë ankimim administrativ dhe të ngrejë padi, duke kërkuar dëmshpërblim.

Megjithëse këto dy ligje janë të nevojshme për të balancuar kërkesa për informacion që duhet të jetë i mbrojtur, Ligji Për të Drejtën e Informimit përcakton se refuzimi i informacionit të kërkuar nuk mund të jetë i menjëhershëm në rastet kur informacioni bie në një nga kategoritë e mbrojtura nga dy ligjet e sipërpërmendura. Sipas ligjit, në këtë rast, autoriteti publik, të cilit i është dërguar kërkesa për informim, fillon menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit pranë autoritetit publik që ka urdhëruar klasifikimin. Paralelisht njoftohet dhe kërkuesi për fillimin e procedurës për rishikimin e klasifikimit sipas ligjit, dhe vendoset shtyrja e afatit për dhënien e informacionit brenda 30 ditëve pune. Në rastet kur kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për njohjen me informacionin arkivor të çdo lloji, pavarësisht nga parashikimet e ligjit për arkivat.



# TESTIMI I LIGJIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Duke pasur parasysh mungesën e të dhënave për zbatimin në praktikë të ligjit për të drejtën e informimit, si dhe rëndësinë që ka kjo e drejtë për një qeverisje sa më transparente dhe për fuqizimin e qytetarëve kundrejt administratës, u krye një testim për masën dhe mënyrën e zbatimit të ligjit nga administrata. Natyrisht, qëllimi kryesor ishte të shihej në terren se si vepron administrata kur gjendet përballë kërkesave për informacion dhe jo informacioni në vetvete. Ky ushtrim është në vazhden e përpjekjeve për të folur me prova konkrete në aspektin e transparencës së administratës publike ndaj qytetarëve dhe medias, si dhe për të identifikuar fushat më problematike ku mund të ndërhyhet në të ardhmen.



## METODOLOGJIA

Testimi i zbatimit të ligjit nisi me krijimin e një kampioni të institucioneve të cilat do të testoheshin për zbatimin e të drejtës së informimit kundrejt qytetarëve dhe medias. Duke qenë se nuk ka një bazë të dhënash që të përfshijë të gjitha institucionet apo administratën, përcaktimi i kampionit për testim ishte disi i ndërlikuar. Qëllimi ishte që përzgjedhja e institucioneve të ishte me një shtrirje të gjerë dhe të larmishme përsa i përket nivelit të administratës, fushës që mbulon, llojit të pushtetit që i përket, problemeve të mëparshme me transparencën, etj. Kjo lloj përzgjedhje synonte të ishte një përfaqësim sa më i arsyeshëm i strukturës së administratës publike shqiptare. Për arsye të kohës dhe mundësive të kufizuara, ky testim i së drejtës për informim u krye vetëm me administratën në kryeqytet. Përzgjedhja e institucioneve përfshinte

administratën qendrore, atë vendore, si dhe institucione shtetërore të pavarura.

Pasi u përcaktua lista e strukturave ku do të kërkohej informacion, u përgatitën 153 kërkesa për informacion. Këto kërkesa ishin relativisht të thjeshta, me qëllim që informacioni i ndërlikuar, i hollësishëm, apo i ndjeshëm të mos bëhej shkas për refuzimin e administratës për të kthyer përgjigje.

Për dërgimin e kërkesave për informacion u krijuan dy grupe. Në grupin e parë, 122 kërkesa u dërguan me letrën me kokë dhe vulën e redaksive përkatëse, të cilat ishin nga mediat kryesore në kryeqytet, si atyre të shkruara, ashtu dhe ato elektronike. Në grupin tjetër, 31 kërkesa u dërguan nga gazetarë, studentë, përfaqësues të shoqërisë civile, qytetarë të thjeshtë, në kërkesë të thjeshtë, pa ndonjë logo apo përkatësi mediatike. Arsyeja për këtë ndarje në grupe ishte që të vërehej nëse ka ndonjë ndryshim në përgjigjet e administratës publike në kërkesat që bën media dhe në ato që bëjnë qytetarë të thjeshtë. Për këtë arsye, pasi secili nga aplikantët hartoi kërkesat për informacion për administratën, gazetarëve iu kërkuar që këto kërkesa t'i paraqisnin me letrën me kokë të medias ku punonin, së bashku me vulën përkatëse dhe me firmën e kryeredaktorit, nëse ishte e mundur. Ndërkohë, grupi tjetër u paraqit me letër të thjeshtë, ku si kontakt ishte lënë adresa e aplikantit, së bashku me numrin e telefonit dhe e-mailin. Asnjë nga kërkesat nuk jepte ndonjë arsye se përse kërkohej informacioni.

Kërkesat për informacion u dërguan në periudhën shtator-tetor 2014, pa ndonjë grafik të caktuar apo të ndarë të dy grupeve nga njëri tjetri. Aplikantëve iu kërkuar që të përpiqeshin të merrnin numrat e protokollit për kërkesat që dorëzonin, si dhe të vinin re të gjitha hollësitë në procesin e aplikimit, të tilla si pritja nga administrata, strukturat përgjegjëse, protokollimi, kontakti me drejtorinë përkatëse, marrja e informacionit, reagimi nga administrata, cilësia e përgjigjes së marrë, koha për t'u përgjigjur, etj.




## REZULTATET KRYESORE TË TESTIMIT NË PRAKTIKË TË SË DREJTËS SË INFORMIMIT

I gjithë procesi i aplikimit të kërkesave për informacion u monitorua për të vërejtur se cilat ishin prirjet kryesore të sjelljes së administratës ndaj kërkesave për informacion. Për këtë qëllim, u bë një analizë si sasiore, ashtu dhe cilësore e hapave të ndryshme të procesit të aplikimit. Kështu, u pa përqindja e kthimit të përgjigjeve, koha për të marrë përgjigje, mënyra e kthimit të përgjigjeve, e kështu me radhë. Gjithashtu, u vërejtën dhe reagimet e administratës ndaj kërkesave për informacion, cilësia e informacionit të dhënë, gatishmëria për të dhënë informacion, si dhe aspekte të tjera të veçanta që mund të vëreheshin. Natyrisht, në fund u bë dhe krahasimi mes dy grupeve, për të vërejtur nëse administrata aplikonte standarde të dyfishta në pranimin dhe kthimin e përgjigjeve për informacion.

28


### ▪ Marrja e përgjigjeve dhe cilësia e tyre

Nga 153 kërkesa për informacion të dërguara pranë niveleve të ndryshme të institucioneve në kryeqytet u morën përgjigje në 91 raste, ndërkohë që në 62 raste të tjera ose u refuzua përgjigjja, ose nuk pati asnjë lloj reagimi nga administrata. Grafiku i mëposhtëm paraqet kthimin e përgjigjeve të marra në përqindje:



Grafiku nr.1 "Kthimi i përgjigjeve" (N=153)

Pra, kemi 41% të kërkesave që nuk kanë marrë asnjë lloj përgjigje nga administrata publike, një përqindje relativisht e lartë e refuzimit të dhënies së informacionit. Një rezultat i ngjashëm u vërejt dhe me monitorimin e kryer në vitin 2012, ku 60% e aplikantëve morën përgjigje. Ndërkohë, grafiku 2 tregon se si ndahet kthimi i përgjigjes në varësi të grupit të aplikantëve, pra nëse aplikanti për informacion është paraqitur si gazetar apo si qytetar i thjeshtë.



Grafiku nr.2 “Marrja e përgjigjes sipas grupit” (N=153)

Si mund të shihet nga grafiku, në grupin e gazetarëve ka një përqindje suksesi më të lartë në marrjen e përgjigjes në krahasim me grupin e qytetarëve të thjeshtë. Kështu, përgjigja iu është refuzuar 38 % të gazetarëve, ndërkohë që në grupin e qytetarëve 50% të tyre nuk u është dhënë përgjigje. Ky diferencim dëshmon për një ndërgjegjësimit dhe gatishmëri më të madhe të administratës ndaj kërkesave të medias dhe për një privilegjim më të madh në krahasim me qytetarët e thjeshtë.

Natyrisht që një element shumë i rëndësishëm dhe domethënës i përgjigjeve të marra është dhe cilësia e informacionit që merret. A është ajo që kërkohet? A është i plotë apo i cunguar? A të orienton administrata në rastet kur i drejtoresh autoritetit të gabuar për një informacion të caktuar? Të gjitha këto pyetje u morën parasysh gjatë vëzhgimit të aplikimit të kërkesave për informacion.

Për qëllimin e vlerësimit të cilësisë së përgjigjeve të marra, llojet e përgjigjeve u klasifikuan paraprakisht në kategoritë e mëposhtme:



**E plotë** = informacioni është ai që kërkohet dhe është i plotë.


**E pjesshme** = informacioni është ai që kërkohet, por jepet i cunguar.

**Negative** = refuzohet kërkesa ose nuk merret asnjë informacion.

**Referencë** = jepet përgjigje duke të këshilluar që t'i drejtohesh një ligji, uebsajti, apo një dokumenti të caktuar.

**Transferta** = përgjigja konsiston në këshillën për t'u drejtuar te një institucion tjetër që është më i përshtatshëm për informacionin e kërkuar.

Grafiku i mëposhtëm paraqet ndarjen e përgjigjeve sipas cilësisë së informacionit të marrë.




Grafiku nr.3 "Lloji i përgjigjes së kthyer" (N=153)

Si mund të vërehet nga grafiku, rreth 27% e gjithë kërkesave për informacion kanë marrë përgjigje që mund të konsiderohet e plotë, kurse 25% e tyre kanë marrë një përgjigje të pjesshme. Ajo që është vërejtur në përgjigjet e pjesshme ka qenë kryesisht dhënia e një informacioni të përgjithshëm, pa specifikat e kërkuara nga aplikanti. Në disa raste, sidomos për gazetarët, ndërkohë që kërkesa bënte fjalë për marrjen e dokumenteve specifike, ato nuk janë dhënë, por është marrë një përmbledhje apo një informacion i përgjithshëm, jo në përputhje me kërkesën.

Në 5% të rasteve aplikantët janë këshilluar t'u referohen ligjeve apo faqeve të internetit. Në disa nga rastet kur aplikantët iu drejtuan faqes së institucionit në internet për të gjetur informacionin e kërkuar, nuk e kanë gjetur atë. Gjithashtu, këshilla për t'iu drejtuar ligjeve apo faqeve të

internetit për të marrë informacionin e dëshiruar presupozon që aplikanti ka si mundësinë, ashtu edhe njohurinë për të përdorur internetin apo për të gjetur ligjin në fjalë, që nuk është doemos e vërtetë. Kjo mund të krijojë shpesh ngërçe, sidomos me popullsinë më të moshuar, pa njohuri dhe mundësi në këtë fushë. Gjithashtu, kjo është edhe një shmangie, sado e lehtë, e administratës nga dhënia e informacionit. Edhe pse informacioni mund të gjendet lehtë online, kjo nuk e përjashton administratën nga detyrimi për t’iu përgjigjur kërkesave që merr nga qytetarët për informacion.

Në 3% të rasteve aplikantët u këshilluan t’i drejtohen një institucioni tjetër për këtë informacion. Kjo praktikë në fakt pati disa aspekte pozitive në institucione të caktuara. Kështu, në disa institucione, kryesisht në Avokatin e Popullit, jo vetëm që aplikanti u orientua të shkonte te një institucion tjetër, por vetë institucioni fillestar e kërkoi informacionin e dëshiruar nga aplikanti te institucioni përgjegjës, si dhe ia ktheu përgjigjen e dëshiruar aplikantit. Këto ishin raste dhe praktika të kufizuara, por gjithsesi vlen të vihen në dukje si shembuj pozitivë në këtë aspekt.



Grafiku nr.4, “Lloji i përgjigjes sipas grupit” (N= 153)


Po të shohim ndarjen e përgjigjeve sipas dy grupeve të caktuara që në fillim, do të vërejmë që ka ndryshim në grupet me përgjigje të plota, ku gazetarët kanë marrë dyfishin e përgjigjeve të plota në krahasim me qytetarët. Më saktësisht 50% të përgjigjeve të gazetarëve janë konsideruar të plota, në krahasim me 26% të qytetarëve. Situata përsa i përket



referencave gjithashtu favorizon gazetarët, të cilëve u është dhënë një përgjigje referencë në 6% të rasteve, krahasuar me 13% të qytetarëve. Edhe në lidhje me transfertat vërehet një favorizim i lehtë i administratës për gazetarët krahasuar me qytetarët, pasi këta të fundit janë transferuar në 6% të rasteve në krahasim me 4% për gazetarët. Pra në përgjithësi, të gjitha kategoritë tregojnë një favorizim të vazhdueshëm, herë më të lehtë dhe herë më të theksuar për gazetarët kundrejt qytetarëve përsa i përket cilësisë së përgjigjes.

### ▪ Koha e kthimit të përgjigjes


Një tjetër element i rëndësishëm i vëzhguar gjatë aplikimit për informacion ishte dhe koha që iu desh administratës për të kthyer përgjigje. Periudha e dërgimit të kërkesave për informacion rastisi me kohën kur në parlament u miratua ligji i ri për të drejtën e informimit, i cili e shkurton ndjeshëm afatin kohor për të dhënë informacion. Megjithatë, duke pasur parasysh kohën që i duhet ligjit të ri për të hyrë në fuqi, llogaria e kthimit të përgjigjes është bërë me ligjin e vjetër. Duke qenë se në ligj lejohej një kohë relativisht e gjatë për të kthyer përgjigje nga ana e administratës, ishte e rëndësishme të shihej se sa kohë merrte në të vërtetë administrata për të kthyer përgjigje, sidomos në raste të kërkesave pak a shumë të thjeshta.



Grafiku nr.5 “Kohëzgjatja e përgjigjes” (N=153)



Duke llogaritur një mesatare të kohës që është dashur për të gjitha kërkesat, janë dashur mesatarisht 12 ditë për të marrë përgjigje për një kërkesë të caktuar. Ky është një përkeqësim në krahasim me vitin 2012, ku mesatarja e marrjes së përgjigjes ishte 9 ditë. Si mund të shihet nga grafiku, 50 përgjigje, pra më shumë se gjysma e totalit, janë dhënë brenda 10 ditëve, ndërkohë që 22 prej tyre janë dhënë brenda 5 ditëve. Ky ritëm i kthimit të përgjigjes mund të konsiderohet relativisht i kënaqshëm, edhe pse në rastin e medias koha mund të duket disi e gjatë. Megjithatë, ka edhe 14 kërkesa që u është dashur më shumë se 20 ditë që të marrin përgjigje dhe 4 të tjerave edhe më shumë se 30 ditë. Pra, ka një prirje që përgjigja kur merret të jetë relativisht e shpejtë, por nuk mund të përgjithësohet në këtë fushë. Ka të ngjarë që ritmi të varet edhe nga informacioni i kërkuar dhe nga infrastruktura e institucionit.



Grafiku nr.6, "Kohëzgjatja e përgjigjes sipas grupit"(N=153)

Ndarja në grupet e medias dhe qytetarëve në marrjen e përgjigjes është interesante, pasi duket se pikërisht ata që e kanë më urgjent normalisht informacionin, gazetarët, e presin më gjatë atë. Kështu, 31% e qytetarëve që kanë marrë përgjigje e kanë marrë këtë përgjigje brenda 5 ditëve, në krahasim me 23 % të gazetarëve. Situata e përqindjes së gazetarëve që kanë marrë përgjigje brenda 10 ditësh është e njëjtë si për qytetarët, ashtu edhe për gazetarët: 31%. Ndërkohë 15% e gazetarëve kanë marrë përgjigje brenda 15 ditëve krahasuar me 12 % të qytetarëve. Gjendja është pak a shumë e njëjtë edhe për kërkuesit që kanë pritur 16-20 ditë për të marrë përgjigje: 10% për gazetarët dhe 12% për qytetarët.



Ndërkohë, 19% e gazetarëve kanë marrë përgjigje për më shumë se 20 ditë, ndërsa 4% e tyre u është dashur më shumë se 30 ditë, në krahasim me një qytetar që gjithashtu iu desh më shumë se 30 ditë për të marrë përgjigje. Ky rezultat mund të lidhet edhe me një informacion më të ndërlikuar që kanë kërkuar gazetarët, apo me kapacitetet e institucioneve përkatëse. Gjithsesi, nuk është një prirje që i ndihmon gazetarët në punën e tyre të përditshme.


### ▪ **Modalitetet e aplikimit dhe përgjigjes**

Një tjetër aspekt i vëzhguar gjatë procesit të aplikimit ka qenë edhe kushtet për aplikimin, lehtësia apo vështirësia në dërgimin e kërkesës, si dhe kthimi i përgjigjes dhe komunikimi gjatë gjithë kësaj kohe.



#### ➤ **Pranimi i kërkesës**

Në monitorimin e ngjashëm që ISHM bëri tre vite më parë, në 2011, dërgimi i kërkesës ka qenë një hallkë relativisht problematike në procesin e aplikimit të kërkesave për informacion. Kjo jo aq për ndonjë tendencë apo pengesë nga ana e administratës, por thjesht për shkak të një mungese të një procedure të unifikuar, të qartë dhe të shpallur për të gjithë në rastin e pranimit të kërkesave për informacion. Gati 40% e kërkesave në vitin 2011 nuk janë pranuar dorazi dhe është kërkuar që ato të dërgohen me



postë, pasi vetëm kështu do të quhej procedura e rregullt. Mesa duket ky është një pësim që u bë mësim, pasi siç shihet nga grafiku, pothuajse gjysma e kërkesave janë dërguar me postë. Gjithashtu, është rritur edhe numri i kërkesave të dërguara me e-mail, gjë që reflekton edhe ndryshimin teknologjik.

Diçka tjetër shumë e rëndësishme që ia vlen të përmendet në dorëzimin e kërkesave ka të bëjë me faktin se në një numër rastesh aplikantët janë pyetur nga administrata se përse e kërkonin këtë informacion. Në vitin 2012, kur u bë testimi i fundit i ngjashëm, kjo ka ndodhur kryesisht me grupin e qytetarëve, gjë që tregon që administrata është më e mësuar me idenë e dhënies së informacionit gazetarëve dhe se janë të rralla kërkesat për informacion nga ana e qytetarëve. Këtë vit, kjo pyetje u është bërë rëndom edhe gazetarëve, edhe pse ligji e shpreh qartë që aplikanti për informacion nuk është i detyruar të shpjegojë motivet.

Kërkesa për informacion në vetvete nuk është refuzuar ose nuk është ndikuar nga pyetjet për arsyen e kërkesës së informacionit gjatë gjithë procesit. Në fakt, shumë nga gazetarët thanë se pasi ishin pyetur pse e donin informacionin, e kishin marrë atë dhe madje të detajuar. Megjithatë, kjo nuk justifikon pyetjen e bërë përse duhet informacioni, në një kohë që ligji është i qartë në këtë pikë.


Një tjetër dukuri jo fort e mirë ka qenë edhe preferenca e dhënies së përgjigjes në varësi të medias që e kërkonte. Shumë gazetarë raportuan raste kur ishte e qartë që informacioni filtrohej ose përshtatej në varësi me median që e kërkonte dhe politikën e saj editoriale. Po ashtu, në disa raste të izoluara autoritetet publike janë lidhur direkt me pronarët e medias për të verifikuar nëse gazetari punonte për ta. Edhe pse këto episode rrallë kanë ndikuar në rezultatin final të marrjes së përgjigjes, përsëri tregojnë se kultura e ndikimit nga politika editoriale e medias apo nga njohjet personale mbetet shumë më e fortë sesa ajo e zbatimit të ligjit.

### ➤ **Marrja e përgjigjes**

Mënyra e marrjes së përgjigjes, në ato raste kur është kthyer përgjigje, ka qenë në mënyra të ndryshme. Duke qenë se aplikantët kishin lënë si kontakte edhe adresë poste, edhe e-mail, edhe telefon, nuk kanë qenë të pakta rastet kur aplikantët janë kontaktuar nga administrata për t'u pyetur



për mënyrën e preferuar të kthimit të përgjigjes. Megjithatë, në më shumë se gjysmën e rasteve, përgjigjet janë kthyer me postë, në rrugë zyrtare, ashtu si dhe është kërkuar që të dërgohen kërkesat.




Grafiku nr. 8, "Mënyra e kthimit të përgjigjes" (N=91)

Si mund të shihet nga grafiku, mënyra më e zakonshme për të kthyer përgjigje ka qenë posta, me 56% të përgjigjeve të marra të dërguara me postë. Pothuajse të gjitha rastet kur përgjigjja është marrë dorazi, ka ndodhur pasi aplikantët janë marrë në telefon dhe janë pyetur se si preferojnë ta marrin përgjigjen, pra me dëshirën e vetë aplikantëve.

Gjithashtu, është për t'u vënë re se në një numër të madh rastesh, aplikantët janë kontaktuar nga ana e administratës para se të merrnin përgjigjen, qoftë me telefon apo me e-mail. Kjo për të sqaruar akoma më tepër kërkesën për informacion dhe për të dhënë informacionin që në të vërtetë nevojitej. Në disa raste, administrata ka shprehur gatishmërinë edhe për pritje në zyrë të aplikantëve, me qëllim sqarimin apo dhënien e informacionit të mëtejshëm.

Nëse do të shohim grafikun që paraqet mënyrën e dhënies së informacionit sipas grupit, është e qartë se ka një dallim të ndjeshëm në kthimin e përgjigjes mes gazetarëve dhe qytetarëve. Nga 51 përgjigje që janë kthyer me postë, vetëm një ka qenë për qytetarët, ndërsa gjithë të tjerat kanë qenë për gazetarët. Gjysma e qytetarëve që kanë marrë



Grafiku nr.9, "Mënyra e kthimit të përgjigjes sipas grupit" (N=91)

përgjigje e kanë marrë atë nëpërmjet e-mailit, në krahasim me 28% të gazetarëve. Po kështu, një pjesë e madhe e qytetarëve, 37%, ka marrë përgjigje nëpërmjet telefonit, ndërkohë që vetëm 6% e gazetarëve ka marrë përgjigje me telefon.



## CITIME NGA PËRVOJA E APLIKANTËVE

“Shumë institucione u përgjigjën me korrektësi, me e-mail, më morën në telefon, më pyetën nëse doja detaje të caktuara. Disa të tjerë nuk morën përgjegjësi. Por në përgjithësi në institucione nuk mungonte dëshira për të dhënë informacion, ndryshe nga vitet e kaluara.”

“Testimi në rastin tim ka qenë pak më keq se në vitet e kaluara: 4 nga 10 institucione u përgjigjën. Kishte dhe tendenca për të parë cila media po e kërkonte informacionin. Kishte pyetje të llojit: “Pse po kërkon ‘Dita’ informacion?” Disa ishin shumë korrekte, por gjithsesi donin të dinin pse po e kërkoja informacionin.”

“Në rastin tim ministritë kanë qenë më korrekte. Më morën në telefon dhe më thanë që do të përgjigjemi brenda kaq ditëve. Institucione të tjera, si INSIG, më morën vetëm për të më pyetur përse e doja informacionin dhe pastaj nuk më kthyen përgjigje fare.”

“Unë mora përgjigje në 8 raste nga 10. Por ajo që vura re është se disa institucione ishin të paqarta nëse ka hyrë ligji i ri apo jo dhe se cilat ishin afatet që duhet të respektonin. Në fakt, frika më e madhe që hasa ishte nëse institucionet po monitoroheshin për afatet.”

“Në eksperiencën time institucionet nuk janë konstante në dhënien e informacionit. Ka nga ata që janë shumë seriozë dhe ka nga ata që nuk janë fare. Në një rast eprori i institucionit më mori në telefon nëse vartësi kishte kthyer përgjigje në kohë. Pati shumë korrektësi dhe mobilizim për të dhënë informacion. Në një rast tjetër thjesht më thanë që duhet të drejtohem në një ministri tjetër. Ndërkohë që kam hasur në arrogancë totale



*në Ministrinë e Arsimit, drejtorët dhe agjencitë në vartësi, ku nuk mora asnjë përgjigje. Në Kryeministri më pyetën përse e doja informacionin dhe pastaj më thanë që e gjeja në internet, pavarësisht se këmbëngula që e doja përgjigje të shkruar.”*

■ *“Hasa një mosbesim të plotë për të dhënë informacion. Disa institucione më pyetën përse e doja informacionin. Ndërsa nga Ministria e Bujqësisë morën në telefon pronarët e medias ku punoj dhe pyetën nëse isha gazetar aty apo jo. Vetëm pastaj më dhanë informacionin që kërkjoja me detaje. Në përgjithësi informacioni duket se filtrohet për media të caktuara, duke i favorizuar disa më shumë se të tjerat. Unë mora përgjigje në 7 nga 10 kërkesa, por ishte e qartë që më ndihmoi fakti se u paraqita si gazetar, edhe kjo pas verifikimeve. Nëse je thjesht qytetar, vështirë se merr përgjigje.”*

■ *“Në përgjithësi tendenca është që të jepet informacion i thjeshtë. Pra ti merr një përgjigje në përgjithësi, po rrallë është thelbësor dhe ajo që ti kërkon në të vërtetë. Ka një lloj hapje të institucioneve, por nuk është norma. Ajo që është shqetësuese është edhe që ndikohen shumë nga ajo se cila media po e kërkon informacionin, gjë që ndikon në përgjigjen që ti merr.”*



## PËRFUNDIMET KRYESORE

Përmirësimi i zbatimit të së drejtës për informim është themelor për një shoqëri më demokratike, më të hapur dhe për një qeverisje më transparente. Miratimi i ligjit të ri për të drejtën e informimit është padyshim një sinjal pozitiv në këtë aspekt. Megjithatë, rezultatet e testimit praktik të ligjit tregojnë se ende duhet një punë e madhe në këtë drejtim, për të ndryshuar praktikën dhe mentalitetin ekzistues për dhënien e informimit atyre që e kërkojnë, qofshin gazetarë apo qytetarë të thjeshtë.

Krahasuar me monitorimet e mëparshme të zbatimit të së drejtës për informim, ky monitorim konfirmoi sërish të njëjtat të dhëna: kërkesat për informacion marrin përgjigje në rreth 60% të rasteve dhe përgjigja nuk është gjithnjë e plotë, thelbësore, apo ajo që kërkohet. Gjithashtu, ai konfirmoi se në një numër të konsiderueshëm rastesh mbeten ende probleme të lidhura me praktikën e administratës në dhënien e informacionit. Fakti se administrata vazhdon të pyesë aplikantët përse e duan informacionin tregon që mbizotëron ende mentaliteti se informacioni i përket administratës dhe ajo e ka në dorë ta japë atë, pavarësisht se ligji thotë ndryshe.

Monitorimi gjithashtu konfirmon standardet e dyfishta të administratës përse i përket trajtimit të gazetarëve nga njëra anë dhe qytetarëve nga ana tjetër. Gazetarët mbeten ende të privilegjuar në marrjen e informacionit në krahasim me qytetarët. Një dukuri tjetër shqetësuese që shfaqet është edhe tendenca për të filtruar informacionin në përputhje me profilin e medias që e kërkon atë. Të gjitha këto të bëjnë të mendosh se e drejta e informimit ende nuk zbatohet njëlloj për të gjithë.





## ANEKS: LISTA E INSTITUCIONEVE TË TESTUARA DHE REZULTATET PËRKATËSE

Nr.	Institucioni	Nr. kërkesave	Përgjigje pozitive	Përgjigje negative
1	Agjencia Kombëtare e Provimeve	2	0	2
2	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	2	0	2
3	Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	2	1	1
4	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	1	1	0
5	Agjencia e Legalizimit dhe Urbanizimit - ALUIZNI-	3	1	2
6	AKEP	2	1	1
7	Arkivi i Ministrisë së Brendshme	1	1	0
8	Avokati i Popullit	4	3	1
9	Bashkia e Tiranës	4	0	4
10	Bashkia Elbasan	2	2	0
11	Biblioteka Kombëtare	1	0	1
12	Departamenti i Administratës Publike	2	0	2
13	Drejtoria e Burgjeve	3	3	0
14	Drejtoria e Hipotekave	1	1	0
15	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	5	4	1
16	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës	1	1	0
17	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	2	2	0
18	Drejtoria e Përmbarimit	1	0	1
19	Drejtoria e Policisë Gjirokastr	1	1	0
20	Drejtoria e Policisë Qarku Tiranë	2	2	0
21	Drejtoria e Tatimeve Tiranë	1	0	1
22	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	1	0	1
23	Enti Rregullator Energjetik	1	0	1
24	Federata Shqiptare e Futbollit	1	1	0
25	Gjykata Administrative e Apelit	1	1	0
26	Gjykata e Apelit	1	0	1



Monitorimi i aksesit në institucione publike

Nr.	Institucioni	Nr. kërkesave	Përgjigje pozitive	Përgjigje negative
27	Gjykata e Lartë	1	1	0
28	Gjykata e Krimeve të Rënda	1	1	0
29	Gjykata e Tiranës	3	3	0
30	Gjykata Kushtetuese	1	1	0
31	ILDKPKI	4	4	0
32	Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor	2	2	0
33	Instituti i Integritit i ish-të Përndjekurve	2	2	0
34	Instituti i Shëndetit Publik	3	0	3
35	Instituti i Sigurimeve Shoqërore	2	0	2
36	INUK	1	0	1
37	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	1	1	0
38	Këshilli i Ministrave	4	2	2
39	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	1	1	0
40	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	1	1	0
41	Komiteti Olimpik Shqiptar	1	1	0
42	Kuvendi i Shqipërisë	2	2	0
43	Ministria e Arsimit dhe Sportit	13	8	5
44	Ministria e Brendshme	5	2	3
45	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	2	1	1
46	Ministria e Drejtësisë	7	5	2
47	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	5	3	2
48	Ministria e Financave	1	0	1
49	Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike	1	0	1
50	Ministria e Integritit	3	1	2
51	Ministria e Kulturës	1	0	1
52	Ministria e Mbrojtjes	1	1	0
53	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	5	3	2
54	Ministria e Mjedisit	3	2	1
55	Ministria e Punëve të Jashtme	5	4	1



Monitorimi i aksesit në institucione publike

<b>Nr.</b>	<b>Institucioni</b>	<b>Nr. kërkesave</b>	<b>Përgjigje pozitive</b>	<b>Përgjigje negative</b>
56	Ministria e Shëndetësisë	4	2	2
57	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	1	1	0
58	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë	3	2	1
59	Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit	1	1	0
60	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë	3	1	2
61	Posta Shqiptare	2	1	1
62	Prokuroria e Përgjithshme	1	0	1
63	Qendra Kombëtare e Regjistrimit	1	0	1
64	Rektorati i Universitetit të Tiranës	2	1	1
65	Shërbimi Informativ Shtetëror	1	1	0
66	Shërbimi Social Shtetëror	2	2	0
67	Universiteti i Tiranës	1	1	0
68	Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive	1	0	1
<b>Gjithsej</b>		<b>153</b>	<b>91</b>	<b>62</b>



## ZBATIMI I TË DREJTËS PËR INFORMIM NË PRAKTIKË

Një nga akuzat më të shpeshta që bëhen ndaj administratës publike lidhet me prirjen për mbyllje ndaj medias dhe publikut dhe mungesën e transparencës. Në këtë aspekt, përdorimi i Ligjit Për Të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare ka qenë mjeti kryesor që kanë pasur mediat dhe publiku në përgjithësi për të marrë informacionin që dëshirojnë nga administrata. Megjithë akuzat dhe pakënaqësinë e vazhdueshme në lidhje me këtë aspekt të punës së administratës, nuk ka pasur shumë përpjekje për të provuar në praktikë se sa qëndron kjo pakënaqësi ndaj administratës.

Testimi në praktikë i të Drejtës për Informim ka qenë sporadik dhe i rrallë. Ka shumë pak informacion për shkallën e njohjes së këtij ligji dhe të drejte nga qytetarët, për masën e përdorimit të këtij ligji, si dhe për respektimin nga administrata të kësaj të drejte. Ndërkohë që media duket se e njih më shumë këtë ligj dhe e përdor më shumë për qëllimet e punës së saj, sërish nuk ka dokumentim të rregullt për përgjigjet që merr nga administrata.

Edhe ato pak studime apo testime në praktikë që janë bërë, janë sporadike, me distancë të konsiderueshme kohe nga njëri-tjetri dhe me një metodologji të ndryshme. Të gjithë këta faktorë nuk lejojnë që të kemi një vështrim krahasimor në kohë për zbatimin e ligjit për të drejtën për informim nga administrata. Gjithsesi, duke pasur parasysh rëndësinë e ligjit dhe sidomos të zbatimit të tij, do të ishte e dobishme që të bëhej një përmbledhje e testimeve të mëparshme në këtë fushë, për të pasur një pasqyrë sa më të plotë të gjendjes dhe problemeve që hasen.



## REZULTATE NGA TESTIME TË MËPARSHME TË SË DREJTËS PËR INFORMIM

- Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve (QZHDI) zhvilloi një proces monitorimi për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit nga administrata publike në vitin 2003. Monitorimi u përqendrua në rrethet Tiranë, Shkodër, Kukës, Vlorë, Lushnjë, Gjirokastrë dhe Elbasan. Institucione të ndryshme vendore, qendrore dhe të pavarura u përfshinë në procesin e testimit. Sipas këtij testimi, shumica e institucioneve nuk kishin zyrë informacioni për qytetarët. Për më tepër, nuk kishte informacion për mënyrën si duheshin trajtuar kërkesat për informacion. Gjithashtu, u vërejt se më shumë se 87% e administratës nuk e dinte që në Shqipëri ekziston ligji për të drejtën e informimit. Po kështu, pati institucione që refuzuan t'i pranonin kërkesat për informacion.
- Një vit më vonë, Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve zhvilloi një tjetër anketim dhe monitorim në lidhje me zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit. Sipas këtij sondazhi, vetëm 23 % e qytetarëve thanë se ishin në dijeni për të drejtën e informimit dhe si mund të përdoret ajo për të marrë informacion pranë administratës. Ndërkohë, në po të njëjtin monitorim, 69% e punonjësve të administratës gabuan përgjigjen për afatin për të dhënë informacion dhe 15 % thanë se nuk pranonin të jepnin informacion nëse kërkesa nuk ishte e motivuar, pra në kundërshtim të plotë me ligjin.
- Avokati i Popullit, sipas ligjit të vitit 1999, ka një rol të veçantë në mbikqyrjen e zbatimit të së drejtës për informim. Edhe pse veprimtaria e Avokatit të Popullit nuk ka rezultuar në monitorime aktive të llojit empirik mbi zbatimin e ligjit, raportet vjetore dhe udhëzimet e Avokatit të Popullit në lidhje me rastet e ankimuar për të drejtën e informimit janë një dritare tjetër mbi trajtimin e kësaj të drejte nga qytetarët dhe administrata. Duke qenë se rastet e ankimit të paraqitura në raportet vjetore të këtij institucioni ndër vite nuk janë të shumta, mund të arrihet në përfundimin se nuk ka një njohje dhe përdorim të gjerë të ligjit nga qytetarët.



- Një burim tjetër i zbatimit në praktikë të së drejtës për informim vjen nga Transparency International Albania. Në përpjekjen e saj për t'u dhënë qytetarëve asistencë ligjore dhe ndihmë në mbledhjen e informacioneve të nevojshme për zgjidhjen e konflikteve administrative, kjo organizatë ka bërë një vëzhgim edhe në lidhje me përqindjen e përgjigjeve të marra nga administrata në këtë proces. Sipas vëzhgimit të bërë në vitin 2011, 58% e kërkesave të dërguara për informacion kishin mbetur pa përgjigje. Në disa raste, edhe pas dërgimit të kërkesës disa herë rresht, nuk është marrë asnjë lloj përgjigje.
- Po në vitin 2011, disa organizata ndërkombëtare si Access Info Europe, Centre for Law and Democracy dhe International Budget Partnership kryen një testim të zbatimit të së drejtës për informim të quajtur "Ask Your government!6 Question Campaign." Në këtë testim u përfshinë 80 vende dhe u testuan institucionet përkatëse në çdo vend në lidhje me 6 pyetje nga fusha të ndryshme. Në renditjen e të gjitha vendeve Shqipëria doli në vend të 25.
- Të njëjtat organizata në 2011 kryen një vlerësim të ligjeve për të drejtën e informimit në 89 vende të botës, nisur nga 61 indikatorë të ndryshëm. Në këtë vlerësim, ligji shqiptar u rendit në zonën me vlerësim të dobët, e pasuar vetëm nga 6 vende të tjera. Kjo tregoi që ligji shqiptar për të drejtën e informimit kishte nevojë për një përmirësim, sidomos krahasuar me pozicionimin shumë të mirë të vendeve fqinje në këtë vlerësim për standardet ligjore të të drejtës së informimit.
- Në 2012 Instituti Shqiptar i Medias kreu një testim të zbatimit të ligjit nga administrata në praktikë. Nga 250 kërkesa për informacion të dërguara pranë niveleve të ndryshme të institucioneve në kryeqytet u morën përgjigje në 60% të rasteve. Për kërkuesit që u paraqitën si gazetarë pati një përqindje suksesi më të lartë në marrjen e përgjigjes në krahasim me grupin e qytetarëve të thjeshtë. Nga përgjigjet e marra rreth 35% e gjithë kërkesave për informacion kanë marrë përgjigje që mund të konsiderohet e plotë, kurse 12% e tyre kanë marrë një përgjigje të pjesshme. Janë dashur mesatarisht 9 ditë për të marrë përgjigje.

- Në vitin 2012-2013 Qendra Respublica gjithashtu ka kryer një testim të së drejtës për informim nga administrata në nivele të ndryshme hierarkie dhe në zona të ndryshme të Shqipërisë. Aplikimet janë bërë në emër të organizatave të shoqërisë civile, avokatëve, gazetarëve, apo individëve. Nga 202 kërkesa të bëra, autoritetet janë përgjigjur në 59 raste, ndërkohë që në 143 raste nuk ka pasur përgjigje. Nga përgjigjet e dhëna 52 janë konsideruar të plota dhe 7 të paplota. Nga 143 rastet e refuzimit të përgjigjes janë paraqitur 142 ankime administrative, ku autoritetet janë përgjigjur pozitivisht në 53 raste dhe negativisht në 89 raste. Përsa i përket shpejtësisë së kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave fillestare, koha mesatare e përgjigjes ka qenë 24 ditë, ku përgjigja më e shpejtë ka qenë 4 ditë, ndërkohë që më e vonuara ka qenë 61 ditë.
- Në vitin 2013 Instituti Shqiptar i Medias kreu një testim për zbatimin e të drejtës së informimit në organet e pushtetit gjyqësor. Nga 50 kërkesa për informacion të dërguara pranë institucioneve të ndryshme të sistemit të drejtësisë dhe atij gjyqësor në kryeqytet u morën përgjigje në 30 raste, ndërkohë që në 20 raste të tjera nuk pati asnjë lloj përgjigje. 30% e gjithë kërkesave për informacion kanë marrë përgjigje që mund të konsiderohet e plotë, kurse 24% e tyre kanë marrë një përgjigje të pjesshme. Janë dashur mesatarisht 10.6 ditë për të marrë përgjigje për kërkesat.



